

Përshëndetje!

Në përgjigje të kërkesës Suaj për informacion nr.171/18, datë 02.07.2018, në kuadër të monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ju bëjmë me dije nga struktura përkatëse brenda Ministrisë:

Në bazë të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, nuk përmban dispozita në lidhje me regjistrimin e shoqatave të mbrojtjes së konsumatorëve. Shoqatat regjistrohen në baze të legjislacionit në fuqi

-Ligji Nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut.

Ligji 9902/2008, i ndryshuar nëpërmjet neni 4, pika f dhe neni 53, parashikojnë të drejtën e konsumatorëve për tu organizuar e për të krijuar shoqata të pavarura konsumatorësh, në mbrojtje të interesave të tyre, sipas ligjit të OJF në fuqi (të sipërpërmendur).

Gjithashtu, pika 3 e Neni 53 të Ligjit 9902/2008, i ndryshuar parashikon disa kritere, që duhet të përmbushin shoqatat e konsumatorëve, në mënyrë që të përfaqësojnë interesat kolektivë të konsumatorëve, të tilla si: anëtarësi aktive, përvojë dhe shtrirje gjeografike.

Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik/Spektori i Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, aktualisht bashkëpunon me katër shoqatat që kanë në misionin e tyre mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Bashkëngjitur lista e shoqatave me të dhënat e tyre.

Duke Ju falenderuar,

Hega Ismaili
Kordinatore për të Drejtën e Informimit.
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Tiranë
Web: www.financa.gov.al

Lista e Shoqatave të Mbrojtjes së Konsumatorëve

Nr	Emer Mbiemer	Emertimi i shoqates	email	Telefon
2	Hajredin Toca Fatmira Bicaku	Shoqata e Konsumatorit Shqiptar	hajredintoca@yahoo.com Fatmirabicaku@outlook.com	692025367 692330451
1	Ersida Teliti	Qendra Konsumatori Shqiptar	gendrakonsumatorishqiptar@gmail.com ersidateliti@yahoo.com	693961511
4	Anula Guda Nikoleta Dervishi	Konsumatori ne Fokus	konsumatorinefokus@gmail.com guda_anula@yahoo.com	698245270 697771563
3	Avni Koldashi Hasan Stafa	Qendra Peshematje-Cmime	peshematjecmime@yahoo.com	692162929